



REPUBLIKA E SHQIPERISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË IMPAKTIT DHE LIÇENSIMIT

AN140420210006

Tiranë, më:10.06.2021

Komisioni 27

VENDIM
PËR VNM PARAPRAKE

Në mbështetje të Ligjit Nr. 12/2015 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, VKM 714, datë: 06.11.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në VKM 686, datë: 29.07.2015, “Për miratimin e rregullave, përgjegjesive e afateve, për zhvillimin e procedurës së transferimit të Vendimit e Deklaratës Mjedisore”, të ndryshuar, AKM-ja pas përfundimit të procedurës paraprake të VNM-së, vendosi që **ky projekt nuk duhet t’i nënshtrohet procedurës së VNM-së thelluar** për zhvilluesin me të dhënat si më poshtë:

Ent Publik: “BASHKIA KOLONJE”

Nr. NIPT-i: K48220001G

Adresa e selisë: Rruga ‘Rilindja’, Nr. banimit: 1, Kati: 1, Kodi postal: 1001,
Erseke, Kolonje Korçë

Personi përgjegjës: Erion Isai

Për të zhvilluar projektin: **“Rikonstruksioni i rrugës Ersekë-Leskovic”**

Aplikimi është bërë referuar Ligjit Nr. 12/2015 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Shtojca II: Pika 10. Prodhime infrastrukturore / d) Ndërtim rrugësh, portesh dhe instalimesh për porte, duke përfshirë dhe portet e peshkimit (projekte që nuk përfshihen në shtojcën I);

Vendndodhja: Erseke-Leskovic , Kolonjë

Të dhëna teknike:

Gjatësia e rruges që do të rikonstruktohet: 42.67 Km

Gjerësia e trupit të rrugës: 6 m

(Bashkangjitur Aneksi I, me planvendosjen e objektit si dhe koordinatat)

1. Arsyet dhe konsideratat kryesore ku është mbështetur ky vendim:

- Aktiviteti nuk cënon jetën e banorëve përreth.

2. Mendimin e institucioneve të konsultuara:

Drejtoria teknike të Ministrisë, shprehën: Cilësia e ajrit në zonën e projektit pritet të ndikohet përkohësisht nga pluhurat dhe grimcat në ajër që do të çlirohen nga punimet e gërmimit të materialit tokësor, transportit, shkarkimet e gazit nga mjetet e transportit dhe pajisjet e punës që do të përdoren gjatë zbatimit të projektit.

Në këtë këndvështrim, sugjerojmë:

- Zbatimin me rigorozitet nga ana e zbatuesit të projektit, të masave të propozuar në këtë raport, për uljen e emetimeve të mundshme në ajër, duke marrë në konsideratë:
- Kontrollin e kushteve teknike në mënyrë periodike të mjeteve të punës, për të evituar, parandaluar rrjedhjet e lubrifikanteve dhe hidrokarbureve në mjedis, emetimin e ndotësve të gaztë, të shkaktuara nga avari teknike të mjeteve.
- Në rastet kur në mënyrë aksidentale ndodh derdhja e karburantit apo vajit, materiali i derdhur të mbliidhet, të pastrohet vendi përkatës, dhe materialet e grumbullura të depozitohen dhe menaxhohen në mënyrë të sigurtë.
- Lënda djegëse që do të përdoret nga mjetet e punës, të jetë në përputhje me kërkesat e legjislacionit specifik për cilësinë e lëndëve djegëse.
- Monitorimin e cilësisë së ajrit gjatë fazës së punimeve, matjen e pluhurave dhe lëndës së ngurtë pezull.
- Zbatimin e Planit të Monitorimit Mjedisor të përshkruar në raportin e VNM-së.
- Spërkatjen e rregullt me ujë të zonës së punimeve pas çdo procesi pune dhe rrugëve të transportit, për mbajtjen nën kontroll të pluhurformimit dhe ngritjes së tij gjatë transportit të materialeve të ndërtimit. Forcimin e zbatimit të këtyre masave edhe më shumë në kohën e thatë dhe me erë.
- Gjatë transportit, mjetet transportuese mos të ngarkohen më shumë se kapaciteti i projektuar dhe të mbulohen me mbulesa, për të parandaluar rrjedhjet në rrugë dhe emetimin e pluhurave.
- Vendosjen e sinjalistikës për punimet në zonën e projektit. Marrja e masave për menaxhimin dhe shmangien e trafikut, që do të krijohet për shkak të makinerive dhe automjeteve transportuese, menaxhimin në kohë të tij.
- Kontrollin dhe mbajtjen e ndikimeve mundësisht brenda zonës së punimeve.
- Punonjësit të përdorin dhe mbajnë rregullisht maskat kundër pluhurit.

Rekomandojmë që të gjitha mbetjet e gjeneruara gjatë ndërtimit të veprimtarisë të menaxhohen sipas kërkesave të përcaktuara në kuadrin ligjor në fuqi në fushën e mbetjeve si më poshtë vijon:

- Ligji nr. 10 463, datë 22.9. 2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar
- Të respektohen kërkesat e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 418, datë 25.06.2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”
- Mbetjet që do të krijohen të specifikohen sipas kodeve të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 99, datë 18.02.2005 “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve” të ndryshuar;
- Transferimi i mbetjeve jo të rrezikshme të shoqërohet me plotësimin e shtojcës 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 229, datë 23.04.2014 “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme”;
- Mbetjet e rrezikshme, të dorëzohen sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 371, datë 11.06.2014 “Për përcaktimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe miratimin e dokumentit të dorëzimit të mbetjeve të rrezikshme.
- Subjekti që do të transportojë ose do të transferojë mbetjet të jetë i pajisur me liçensë III.2.B , si detyrim i nenit 57, të ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve “ i ndryshuar;
- Mbetjet inerte të gjeneruara të trajtohen sipas kërkesave të Vendimit të Këshillit të

Ministrave nr. 575, datë 24. 06. 2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”;

- Rekomandojmë të kryhen punime cilësore dhe rezistente ndaj ngjarjeve ekstreme të motit.
- Duke patur parasysh se ndikimi në ajër i ndotjes akustike për këtë lloj aktiviteti do të jetë i përkohshëm, sugjeroj të zbatohet legjislacioni specifik në lidhje me zhurmat dhe me nivelet kufi të zhurmave.

- Rekomandojmë të merret në konsideratë dhe të zbatohet kuadri ligjor mjedisor dhe institucional në fuqi, për sa i përket pyjeve dhe kullotave në Republikën e Shqipërisë, përkatësisht Ligji Nr. 57/2020, datë 30.04.2020, “Për Pyjet” dhe Ligji nr.9693, datë 19.3.2007, “Për fondin kullor”, i ndryshuar.

- Raporti duhet të kishte marrë parasysh alternativa të tjera në lidhje me projektin, si për vendin e zhvillimit ashtu edhe për modifikimet e mundshme në faza të ndryshme të tij. Një vlerësim i duhur i alternativave përfshin përshkrimin e tyre, paraqitjen e pasojave të tyre mjedisor, dhe një shpjegim të arsyeve për pranimin ose refuzimin e tij. Burimet e të dhënave dhe të informacionit për mjedisin ekzistues nuk janë referuar si duhet. Kriteret dhe burimet e standardeve të cilësisë, të përdorura në vlerësim, duhet të paraqiteshin në mënyrë të qartë. Nuk janë përshkruar ndikimet kumulative të projektit në mjedis, së bashku me zhvillimet e tjera ekzistuese ose të planifikuara të zonës.

- Për sa i përket parandalimit dhe zvogëlimit të pasojave në mjedis dhe rehabilitimit të mëvonshëm të tij, sugjerojmë:

- Vendosjen e shenjave paralajmëruese rrugore dhe përgatitjen e udhëzime për drejtuesit e automjeteve, me qëllim uljen e numrit të vrasjeve aksidentale të kafshëve;
- Sigurimin e të gjitha paisjeve të nevojshme për riparim, pastrim dhe ndërhyrje në rast emergjencash;

Njoftimin e menjëhershëm të autoriteteve dhe njësive të specializuara në rast emergjencash (zjarrfikës, etj.);

- Kur është e mundur, nivelet e zhurmës gjatë orëve të agimit, muzgut dhe natës duhet të minimizohen për të zvogëluar shqetësimin, veçanërisht për gjitarët dhe shpendët;

- Me rëndësi të veçantë është rehabilitimi i peizazhit në të gjithë gjurmën e projektit;

- Të minimizohet dëmtimi i sipërfaqëve të panevojshme gjatë ndërtimit;

- Për mbjellje të përdoren lloje vendase, të përshtatura me kushtet e substratit dhe të klimës në zonë si: Dafina (*Laurus nobilis*), Ilqja (*Quercus ilex*), Dëllinja (*Juniperus* sp.), Lofata (*Cercis siliquastrum*), Boshtra (*Forsythia europaea*), Fshikartha (*Colutea arborescens*), etj. Drurëve dhe/ose shkurreve të përdorura për rehabilitimin e mjedisit të dëmtuar duhet t’u sigurohet substrati i duhur i tokës dhe kushtet e mjaftueshme për të mbijetuar.

- Të merren masa për parandalimin e futjes së llojeve të huaja (aliene) invazive.

- Gjatë fazës së zhvillimit të punimeve të mënjanohej dëmtimi i individëve bimorë që nuk e pengojnë shfrytëzimin dhe nëse konstatohet bimësi me vlerë (ekonomike, mjekësore, me status mbrojtjeje, etj.), ajo të ruhet dhe të lajmërohen autoritetet përgjegjëse për marrjen e masave përkatëse për ruajtjen.

- Në asnjë rast të mos dëmtohen habitatet natyrore kufitare dhe llojet bimorë që gjenden përgjatë gjithë kufirit të projektit. Në çdo rast të dëmtimit të drurëve të bëhet kompesimi i tyre sipas legjislacionit në fuqi.

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura shprehet: Bashkia Kolonjë, nëpërmjet aplikimit nr. AN140420210006 për VNM paraprake kërkon të zhvillojë investimin “Rikonstruksionii rrugës ekzistuese Ersekë-Leskovic”, nëpërmjet FSHZH-së, duke ruajtur gjurmën ekzistuese të rrugës që lidhë këto dy qytete.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dërguar (Raportit Teknik dhe VNM) , projekti do të zhvillohet mbi gjurmën e rrugës ekzistuese Ersekë – Leskovik., e cila shtrihet përmes zonës së mbrojtur RNM “Gërmenj”, miratuar me Vendim të KKT-së nr 10 datë 28.12.2020 “Për miratimin e kufijve të zonave të mbrojtura”. Gjithashtu në afërsi të trasesë së rrugës ndodhen edhe tre monumente natyror si Pisha e Pogonicës (Sotirë Radanj) dhe Rrapi i Leskovikut. rezulton se projekti prek në MN “Mogilat e

Vasjarit”, shpallur me VKM-në nr. 303, datë 10.05.2019 “Për miratimin e listës së rishikuar, të përditësuar të monumentave të natyrës Shqiptare”, kategoria e III e zonave të mbrojtura, Nisur nga rëndësia sociale që ka kryerja e këtij investimi për nevojat publike si dhe nga fakti se investimi do të kryehet në rrugën ekzistuese, **shprehemi pro, me kusht që:**

- të mos bëhet zgjerim i trasesë së rrugës ekzistuese,
- të mos cënohen (dëmtohen) monumentet natyror, gjatë kryerjes së punimeve,
- të mos dëmtohet pylli dhe të mos pritet asnjë pemë,
- inertet e ngurta që rezultojnë të largohen duke i depozituar jashtë zonës së mbrojtur,

Agjencia Rajonale e Mjedisit shprehet: Parimisht dakort për zhvillimin e aktivitetit

3. Masat që duhen marrë për të shmangur, reduktuar ose korrigjuar ndikimet negative të mundshme në mjedis:

- 3.1. Ky objekt të ndërtohet në përputhje të plotë me Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Planin e Detajuar Vendor, të miratuar nga organet kompetente (KKT / Bashkia / Njësi Administrative)dhe akteve ligjore në fuqi.
- 3.2. Ky Vendim është i vlefshëm pasi subjekti të marrë miratim nga institucionet përkatëse për këtë lloj aktiviteti.
- 3.3. Të zhvillohet projekti vetëm në gjurmën e strukturës/ve të propozuar dhe miratuar nga autoritetet kompetente.
- 3.4. **Referuar mendimit të Akzm-së të zbatohen me rigorozitet kushtet:**
 - të mos bëhet zgjerim i trasesë së rrugës ekzistuese,
 - të mos cënohen (dëmtohen) monumentet natyror, gjatë kryerjes së punimeve,
 - të mos dëmtohet pylli dhe të mos pritet asnjë pemë,
 - inertet e ngurta që rezultojnë të largohen duke i depozituar jashtë zonës së mbrojtur
- 3.5. Në rast se gjatë punimeve shfaqen elemente të tilla si: objekte kulti, gjurmë arkeologjike, burime ujore etj, subjekti të ndërpresë punimet dhe të lajmërojë urgjentisht organet kompetente.
- 3.6. Lendët e para të domosdoshme për ndërtimin e rrugës, të sigurohen nga kompani të licencuara.
- 3.7. Në rast se kjo sipërfaqe prek fond pyjor, subjekti duhet të bëjë kërkesë pranë institucioneve përkatëse për heqje nga fondi pyjor.
- 3.8. Të merren masa për të parandaluar rëniet e zjarrit gjatë realizimit të punimeve në terren dhe të sigurohen mjetet e nevojshme të ndërhyrjes në rast të rënies sëzjarrit (zjarrfikse të lëvizshme, bombula me shkumë, etj);
- 3.9. Nivel i zhurmave gjatë procesit të jetë brenda normave të lejuara dhe të punohet në orare kur shqetësimi i banorëve dhe zonave përreth të jetë me ndikim sa më të ulët
- 3.10. Të bëhet rrethimi i zones ku do të realizohen punimet, për të shmangur hyrjet e paautorizuara.
- 3.11. Operacionet për zbatimin e projektit (ndërtimi) të përdorin sa më shumë të jetë e mundur infrastrukturën egzistuese të transportit (rrugën dhe rrjetet egzistuese).
- 3.12. Të kontrollohen kushtet teknike të mjeteve të punës në mënyrë periodike për të evituar, parandaluar rrjedhjet e lubrifikantëve e të hidrokarbureve në mjedis, emetimin e gazeve të shkaktuara nga avari teknike të mjeteve të subjektit.
- 3.13. Të bëhet pastrami i mjeteve të punës para daljes nga kantieri I ndërtimit për të mos shkaktuar ndotje në mjedis.
- 3.14. Subjekti të kujdeset për menaxhimin e mbetjeve të krijuara nga veprimtaria, ato të ambalazhimit dhe ndërtimit, duke i transportuar nëmënyrë të rregullt në vend grumbullimet e caktura nga njësia vendore. Zotëruesit e mbetjeve inerte duhet të zbatojnë detyrimet që janë të

përcaktuara në VKM nr.575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”.

- 3.15. Të mos hidhet asnjë mbetje e ngurtë ose e lëngët në mjedisin ujq dhe atë tokësor.
- 3.16. Subjekti të realizojë në mënyrë të menjëhershme çdo ndërhyrje teknike për të riparuar çdo fenomen negativ në mjedis si pasojë e veprimtarisë së tij.
- 3.17. Kompania të ndjek me përpikmëri projektin teknik për të evituar erozionin e tokës, me qëllim ruajtjen e cilësisë së ujrave sipërfaqësore dhe nëntokësore.
- 3.18. Të vendoset sinjalistika paralajmëruese përgjatë gjithë segmentit të punimeve me qëllim shmangien e aksidenteve njerëzore.
- 3.19. Furnizimi me ujë të pijshëm të bëhet në tubacionin kryesor, me miratimin të organeve kompetente.
- 3.20. Furnizimin me energji elektrike të bëhet konform kërkesave e me miratimin të organeve kompetente.
- 3.21. Në raste aksidentesh ose defektesh teknologjike që shkaktojnë ndotje të mjedisit, subjekti menjëherë duhet të jap informacion në DRM-në e qarkut përkatës dhe AKM, të cilat bëjnë të mundur njoftimin e populates që preket nga ky aksident.
- 3.22. Para fillimit të veprimtarisë të trajnohen të gjithë punëtorët e subjektit si dhe të njihen me termat dhe kushtet e sipërcituara në Vendim.
- 3.23. Të kryhet mirembajta dhe gjelbërimi në mënyrë të vazhdueshme i mjediseve përreth objekteve duke ruajtur një imazh të këndshëm dhe minimizuar ndikimet në mjedis.
- 3.24. Kompania duhet të respektojë të gjitha kushtet teknike të ndërtimit sipas akteve ligjore dhe nën ligjore në fuqi.
- 3.25. Kompania duhet të respektojë gjithashtue dhe kushtet e vendosura në raportin e VNM-së që është paraqitur në aplikim si dhe të ketë parasysh Ligjin Nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”;

4. Monitorimi dhe Raportimi

Në bazë të Ligjit Nr. 128/2020 Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, të ndryshuar, Neni 25/1 “Monitorimi dhe vlefshmëria”, zhvilluesi ka detyrimet si më poshtë:

- Zhurma dhe Vibracionet

- Të zbatohen nivelet kufi të zhurmës, referuar Udhëzimit Nr. 8, datë 27.11.2007 “Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara” dhe Ligjit Nr.9774 datë 12.07.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”
- Të merren masa për mbrojtjen e punonjësve nga zhurmat.
- Të merren masat për kufizimin e orareve të punës në kantier.
- Operatori duhet të parandalojë gjenerimin e zhurmës impulsive në zonat e ndjeshme ndaj zhurmës, gjatë operimit të instalimeve.
- Vibrimet në vende të ndjeshme nuk duhet të kalojë 10 mm/s (PPV) në çdo kohë.
- Të bëhet monitorimi i zhurmave për mjediset: automjete/kamiona në hyrje të kantierit, kantier ndërtimi dhe mjedisi urban më i afert me kantierin çdo 6 muaj.

Tabela e niveleve kufi:

Mjedisi	Vlera kufi e zhurmës dB(A) Leq, T Ditë	Vlera kufi e zhurmës dB(A) Leq, T Mbrëmje	Raportimi në AKM	Periodiciteti
Automjete/kamiona në hyrje të kantierit	55	45	12.12.2021	Çdo 6 muaj
Kantier ndërtimi	55	45	12.12.2021	Çdo 6 muaj

Mjedisi urban me i afert me kantierin	55	45	12.12.2021	Çdo 6 muaj
---------------------------------------	----	----	------------	------------

- **Shkarkimet në Ajër**

- Të zbatohen nivelet kufi të shkarkimeve në ajër, referuar Ligjit Nr. 162/2014 “Për Mbrojtjen e Cilësisë së Ajrit në Mjedis” dhe VKM Nr. 248, datë: 24.03.2003 “Për Miratimin e Normave të Përkohshme të Shkarkimeve në Ajër dhe Zbatimin e tyre”.
- Shkarkimet në ajër të jene brenda normave të lejuara, duke marre masa për reduktimin e tyre.
- Kantieri në të cilin emetohen lëndë grimcore në ajër, duhet të pajiset sipas mundësive teknike dhe mbi bazën e natyrës së procesit, me rrjeta uji / sisteme spërkatje / sisteme heqje pluhurash.
- Të bëhet monitorimi i nivelit të pluhurave në ajër, për mjediset: kantier ndërtimi dhe mjedisi urban më i afërt me kantierin çdo 6 muaj.

Tabela e niveleve kufi

Ndotësi	Përqëndrimi	Raportimi në AKM	Periodiciteti
Lënda grimcore (PM _{2.5})	20-25 µg/m ³	12.12.2021	Çdo 6 muaj
PM ₁₀	50 µg/m ³ 40 µg/m ³	12.12.2021	Çdo 6 muaj

- **Subjekti duhet të sjellë pranë AKM-së si më poshtë:**
- Informacion në momentin e fillimit të punimeve
- Raportimin periodik për parametrat që do të monitorohen sipas datës së raportimit / çdo 6 muaj.
- Informacion në përfundim të punimeve, lidhur me punimet rehabilituese të territorit përreth, shoqëruar edhe me foto.
- **Afati i Vlefshmërisë**
- Vendimi për VNM-në paraprake për projektin e propozuar është e vlefshme për aq kohë sa është i vlefshëm edhe dokumenti i miratimit të zhvillimit për projektin.
- Nëse projekti, që i është nënshtruar procesit të VNM-së, nuk fillon zbatimin në terren brenda 2 vjetëve nga data e miratimit të deklaratës mjedisore apo të vendimit për VNM-në paraprake, atëherë këto dokumente konsiderohen të pavlefshme dhe procesi i VNM-së fillon nga e para.

Në bazë të udhëzimit të MM dhe MF nr. 7938, datë 17.7.2014 “Për përcaktimin e tarifave dhe vlerave përkatëse për shërbimet që kryen Ministria e Mjedisit për procesin e VNM-së”, ky subjekt ka kryer pagesën 30.000 lekë

DREJTORI I PËRGJITHSHËM I AKM

Konceptoi:

Miratoi:

Aneksi 1. Planvendosja e sipërfaqes së objektit

- Planvendosja e rrugës Ersekë Leskovik



Koordinatat e rrugës që do të rikonstruktohet sipas Sistemit GAUS KRUGE ZONE 4 janë si më poshtë:

Projekti	Koordinatat sipas sistemit koordinativ GAUS KRUGE ZONE 4		Koordinatat sipas sistemit koordinativ KRGJSH	
	X	Y	X	Y
Koordinatat e fillimit të segmentit rrugor	4472835.79	4466523.93	557685.208	4466566.252
Koordinatat e fundit të segmentit rrugor	4466220.98	4446812.82	551288.483	4446778.680
	Gjatësia L= 42.67 Km Gjerësia e trupit të rrugës 6m			